

HAPAT!

Në Maqedoni skriningu zbatohet me teste FOB të cilët i siguron Ministria e shëndetësisë.

Testet BOB u janë shpërndarë mjekëve amë dhe ata vendosin se cilëve pacientë do ju ofrojnë kontroll me testim për zbulim të hershëm të kancerit të zorrës së trashë. Përparësi kanë personat që në anamnezën e tyre kanë të dhëna për prani të faktorëve të rrezikut (person të afërm të sëmurë nga kanceri, polipe kolorektale, probleme me jashtëqitjen dhe probleme të tjera). Pacientët tek mjekët e tyre amë mund të marrin nga tre teste FOB, të cilët mjaftojnë për ta vërtetuar praninë e gjakut në jashtëqitje.

Flakonet me materialet pastaj dërgohen pranë Qendrave të shëndetit publik për analizë dhe fitim të rezultateve. Në rast se testi është pozitiv, mjeku amë e udhëzon pacientin për të bërë analiza shtesë, që të mund të vërtetohet nëse pacienti vuan nga KKR dhe se në ç'stad është sëmundja. Me vërtetimin e diagnozës pozitive fillon edhe trajtimi i pacientit. Trajtimi më i shpeshtë drejt shërimit është ndërhyrja kirurgjikale. Nëse kanceri është përhapur, para ose pas ndërhyrjes kirurgjikale pacienti mund t'i nënshtrohet rrezatimit ose kimioterapisë.

Bëjeni testin FOB dhe ndaloni sëmundjen!

ZVOGËLIMI I RREZIKUT DHE ZBULIMI I HERSHËM I KANCERIT TË ZORRËS SË TRASHË SHPËTON JETË!!!

Prandaj:

- Bëni aktivitete fizik të paku 30 minuta, më së paku 5 ditë në javë!
- Mirëmbani peshën trupore!
- Mos pini duhan! Nëse jeni duhanpirës, hiqni dorë nga duhani!
- Kur bëhet fjalë për rrezikun nga kanceri i zorrës së trashë, këshilla më e mirë është: Nëse nuk pini alkool, mos filloni fare të pini! Për ata që tashmë pinë alkool, Instituti Amerikan për hulumtimin e kancerit (AICR), rekomandon që sasi të e alkoolit të jenë si vijon:
 - Për gratë, jo më shumë se një pije alkoolike në ditë, ose 45 ml!
 - Për meshkujt, jo më shumë se dy pije alkoolike në ditë, ose 90 ml!
- Konsumoni fruta, perime dhe drithëra integrale. To do ju ndihmojnë të jeni të shëndetshëm dhe të mbeten të tillë!
- Konsumoni më pak mish të kuq dhe përpunime të tjera të mishit!



Republika e Maqedonisë
Ministria e shëndetësisë




Instituti i shëndetit publik i
Republikës së Maqedonisë



**MËSO PËR
ZBULIMIN E
HERSHËM TË
KANCERIT
NË ZORRËN E
TRASHË!**

Kanceri i zorrës së trashë është një sëmundje malinje që prek edhe femrat edhe meshkujt. Në fazat e hershme zakonisht nuk manifeston simptoma. Në fazë më të avancuar tek njerëzit mund të paraqiten këto simptoma:



- Gjakderdhje nga zorra e trashë ose jashtëqitje me gjak;
- Ndryshim të ritmit të zakonshëm të punës së zorrës së trashë;
- Jashtëqitje më të lëngëta se zakonisht;
- Diarre, konstipacion ose ndjenja se lëvizja në zorrën e trashë nuk është e plotë;
- Rënie në peshë pa ndonjë shkak;
- Mungesë energjie;
- Të vjella

Më të rrezikuarit

- Personat në moshë mbi 50 vjet;
- Personat që pinë duhan;
- Personat me mbipeshë ose që janë shumë të shëndoshë, sidomos personat pesha e të cilëve është e përqendruar në pjesën rreth mesit;
- Personat që nuk merren me aktivitete fizike;
- Personat që konsumojnë sasi të mëdha të alkoolit, sidomos meshkujt;
- Personat që konsumojnë sasi të mëdha të mishit të kuq (mish viçi, derri apo qengji) ose përpunime të mishit (proshutë, salsiçe, sallam, etj);
- Personat me anamnezë personale ose familjare me kancer kolorektal ose me polipe kolorektale beninje (jo-kancerogjene);
- Personat që kanë vuajtur ose vuajnë nga sëmundje inflamatorë të zorrës së trashë (si koliti ulçeroz ose sëmundja e Kronit)

Nëse keni ndonjë nga simptomat e kancerit kolorektal, vizitoni mjekun Tuaj!!!

Skriningu është metodë për zbulimin e sëmundjes para se të paraqiten simptomat e saj. Ai mundëson zbulim të kancerit në një stad të hershëm, para se ai të kalojë në formë invazive. Skriningu ka për qëllim të evitojë vdekjen, të zvogëlojë morbiditetin

dhe të përmirësojë cilësinë e jetës të personave që kanë kancer. Ai ka për qëllim të zvogëlojë rrezikun, por nuk paraqet metodë për diagnostikimin sëmundjes. Ekziston një spektër i gjerë i metodave të ndryshme për skrining të kancerit kolorektal, por përvojat nga studimet që kanë pasur për qëllim të identifikojnë protokollin më efektiv për skrining për përdorim tek popullata simptomatike e përgjithshme anojnë kah testi për zbulimin e zbulimi të gjakderdhjes kulte ose i ashtuquajturit testi **FOB (Fecal Occult Blood Test - FOBT)**.

Asociacioni Amerikan i gastroenterologjisë ka rekomanduar që personat në moshë mbi 50 vjet ta bëjnë testin për gjakderdhje kulte në jashtëqitje së paku një herë në vit. Për shkak se kanceri i zorrës së trashë, i cili njihet edhe si kanceri kolorektal, ka si simptomë gjakderdhjen, analiza për prani të gjakderdhjes kulte mund të selektojë kandidatët për analiza më të detajuara me procedura endoskopike ose radiologjike.

